



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Përgjithshëm

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202001144/2

Tiranë ___/___/2020

Lënda : *Rekomandojmë verifikimin nga administrator social i gjendjes social-ekonomike të shtetasit E.K dhe plotësimin e saktë të Formularit "Verifikimi i situatës social-ekonomike".*

Drejtuar: Z. Bujar XHAFA
Administrator
Njësia Administrative Nnr.8

TIRANË

I nderuar Z.XHAFA,

Pranë institucionit të Avokatit të Popullit, më datë 17.12.2019, ka paraqitur ankesë shtetasi E.K, në përmbajtjen e së cilës ankohet për mosmarrje përgjigje lidhur me kërkesën e tij për mosplotësim të saktë të Formularit «*Verifikimi i situatës social-ekonomike*».

Institucioni i Avokatit të Popullit, si një institucion kushtetues në mbrojtje të të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj, ka vendosur pranimin e ankesës dhe shqyrtimin e saj.

Sipas shpjegime të tij, ankuesi është i moshës 66 vjeç dhe jeton prej tre vitesh në një rulotë, të vënë në dispozicion nga Emergjencat Civile në Shtish-Tufinë.

Duke qenë se jeton i vetëm dhe në pamundësi financiare për të përballuar jetesën e përditshme, ka bërë kërkesë për t'u sistemuar në një institucion publik rezidencial për të moshuarit. Me qëllim që të plotësojë dokumentacionin ligjor, ka kërkuar që të pajiset me Formularin e "*Verifikimit të situatës social-ekonomike*".

Shtetasi E.K pretendon se pavarësisht kërkesave të bëra, nuk i është plotësuar saktë Formulari «*Verifikimi i situatës social-ekonomike* », pasi administratori social nuk shkon për të kryer verifikimin në vend.

Duke e konsideruar këtë çshtje si shkelje të të drejtave të tij ligjore, ka kërkuar ndihmën e Avokatit të Popullit.

Nga dokumentacioni i depozituar, konstatojmë se ankuesi është pajisur me të gjithë dokumentacionin ligjor të kërkuar për ta paraqitur pranë Dejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, Tiranë, por Formulari i «*Verifikimit të situatës social-ekonomike* », nuk është plotësuar saktë, pasi nuk është kryer verifikimi në vend për të parë realisht kushtet në të cilat ndodhet shtetasi E.K, por është vënë vetëm shënimi më dat 16.12.2019 :

«Qytetari deklaron që nuk ka banesë në pronësi dhe jeton në Rulotë të Emergjencës Civile ».

Rezulton se, për ta pasqyruar saktë në formular gjendjen social-ekonomike të shtetasit E.K, nuk është bërë verifikimi në vend nga administratori social.

E drejta për t'u sistemuar dhe përfituar statusin e rezidentit bëhet mbi bazën e kërkesave normative të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.425 datë 27.06.2012 «*Për përcaktimin e kriterëve dhe të dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në institucionet rezidenciale, publike dhe jopublike, të përkujdesjes shoqërore* », i cili në Kreun III të tij, ka përcaktuar kriteret, dokumentacionin dhe nismën për pranimin e personave të moshuar në institucionet rezidenciale publike dhe jopublike, të përkujdesjes shoqërore. Konkretisht, personat e moshuar, për t'u pranuar në institucionet e përkujdesjes shoqërore, duhet të përmbushin këto kriterë :

- a) *Të vijnë nga familje patë ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme.*
- b) *Të vijnë nga familje në nevojë, të vlerësuara nga administratori shoqëror,*
- c) *Të jenë të vetmuar, të braktisur dhe pa të ardhura*
- d) *Të kenë mbushur moshën për pension, sipas legjislacionit në fuqi.*

Në dokumentacionin e nevojshëm për pranimin e personave të moshuar në institucionet e përkujdesjes shoqërore përfshihen :

- a) *kërkesa me shkrim nga vetë personi ose familja, nga të afërmit e ti apo administratori shoqëror i njësisë ku banon, me miratimin e personit të moshuar,*
- b) *çertifikata e gjendjes civile , c) çertifikata e gjendjes familjare,*
- ç) *fotografi e personit (2 copë),*

d) vërtetimi nga sigurimet shoqërore, nëse përfiton ose jo pension pleqërie apo ndonjë lloj pensioni tjetër

e) vërtetimi i lëshuar nga administratori i njësisë së ndihmës dhe përkujdesjes shoqërore për gjendjen ekonomike të familjes së personit të moshuar.

Nga të gjitha dokumentat e kërkuara ligjore, rezulton se shtetasi E.K, nuk ka të plotësuar saktë vërtetimin e lëshuar nga administratoti i njësisë së ndihmës dhe përkujdesjes shoqërore për gjendjen ekonomike të tij, sipas gërmës «e» të vendimit të sipërcituar. Kjo situatë, ka penalizuar këtë shtetas për të paraqitur të gjithë dokumentacionin pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, Tiranë.

Sjellim në vëmendjen Tuaj se, mbi bazën e kërkesës së të moshuarit ose të interesuarve të tjerë dhe plotësimit të dokumentacionit që vërteton situatën social-ekonomike të të moshuarit/ës dhe pas verifikimit të situatës social-ekonomike dhe shëndetësore, të vërtetuar edhe nga organet e pushtetit vendor, Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror (sipas Qarkut përkatës), ka të drejtë të kërkojë vendosjen në një nga institucionet e shërbimit rezidenlcial për të moshuarit. Vendimi për institucionin se ku do të sistemohet i moshuari, kryhet pas miratimit nga Komisioni i Pranimit në Shtëpitë e të Moshuarve pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror¹

Referuar Vendimit në Këshillit të Ministrave nr.518 datë 04.09.2018 « *Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar* », në nenin 34 thuhet shprehimisht :

« Pas depozitimit të kërkesës me shkrim nga të interesuarit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 13, të kreut III, të këtij vendimi, punonjësit social në njësinë e qeverisjes vendore për vlerësimin dhe referimin e rastit/Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve, plotëson dosjen e individit me këto dokumente dhe të dhëna :

- a) Verifikimin mbi gjendjen social-ekonomike të famijes,*
- b) Përbërjen familjare aktuale nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile i vitit 2010,*
- c) Të ardhurat e familjes nga sistemi i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve ».*

Sa më lart, me qëllim shqyrtimin e kërkesës së shtetasit E.K nga Komisioni i Pranimit në Shtëpitë e të Moshuarve pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63 të Kushtetutës së

¹ Faqja zyrtare DPSHSSH

Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike*”; në bazë të nenit 21/b të Ligjit “Për Avokatin e Popullit”, ku thuhet se : “*Paraqet rekomandime për venien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive*”,

REKOMANDOJMË

Verifikimin nga administratori social i gjendjes social-ekonomike të shtetasit E.K dhe plotësimin e saktë të Formularit “*Verifikimi i situatës social-ekonomike*”.

Në përputhje me nenin 22, të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 “*Për Avokatin e Popullit*”, i ndryshuar, ku thuhet se; “*Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet t’a shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit*”.

Bashkëlidhur ju dërgojmë kopje të Formularit “*Verifikimi i situatës social-ekonomike*”.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin Tuaj,

K O M I S I O N E R

Vilma SHURDHA